



British Gymnasium
of Technology

Këshilli Drjetues (KD) i Gjinnazit Britanik për Teknologji (BGT), bazuar në Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me qëllim të parandalimit të sjelljeve të pa venda dhe pa hijshme, bazuar në kompetencat e përcaktuara me aktet e brendshme, miraton këtë:

RREGULLORE PËR CËSHTJE DISIPLINORE PËR NXËNËS

Neni 1

Qëllimi

1. Rregullorja synon të krijoj një kulturë mirësjelljeje dhe përgjegjshmërie në BGT.
2. Kjo rregullore përcakton qartë shkeljet disiplinore dhe masat disiplinore për nxënësit e BGT-së.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore vlen për të gjithë nxënësit e BGT-së.
2. Përmes kësaj rregulloreje përcaktohen të drejtat, detyrimet, kufizimet dhe lejitimet në cdo proces në shkollë, duke përfshirë por mos u kufizuar në procesin mësimor, jashtë-mësimor, mbarvajtjen e të gjitha punëve në BGT, sjelljet mes stafit, mes nxënësve, dhe mes stafit dhe nxënësve.
3. Rregullorja përcakton shkeljet disiplinore, ndërsa për shkeljet Etike vlen Kodi i Mirësjelljes.

4. Rregullorja e disiplinës së shkollës është e detyrueshme për të gjithë nxënësit dhe prindërit, poashtu. Cilido, sipas detyrës dhe kompetencave të veta, duhet të ndihmojnë që rregullat të zbatohen me ndershmëri dhe rigorozitet.

Neni 3

Obligimet dhe përgjegjësitë e nxënësit

BGT përgjegjësitë dhe obligimet e nxënësit i cakton si në vijim:

1. Paraqitja në mësim sipas orarit shkollor është e detyrueshme për të gjithë.
2. Pushimi i shkurtër ose pushimi mes orëve shërben për nxënësit vetëm për t'i kryer nevojat personale dhe për të shkuar në sallën e mësim-detyrës në orën e ardhshme.
3. Të jenë të përgatitur për orën e mësim, të kryejnë detyrat e shtëpisë dhe të jenë të disiplinuar.
4. Të jenë të pajisur me tekste shkollore dhe mjetet e nevojshme për mësim, punë praktike, aktivitete sportive, dhe të tjera.
5. Nxënësit që mungojnë në shkollë duhet të futen në klasë vetëm pas justifikimit dhe arsyetimit të prindit ose kujdestarit që e zëvendëson atë.
6. Arsyetimet për mungesat duhet të bëhen në kohë nga ana e prindërve
7. Mungesat për arsye shëndetësore mund të justifikohen vetëm me raport mjekësor tek kujdestari i klasës ose më largU se 48 orë para orës së mësim.
8. Vonesat e shpeshta do të raportohen familjeve dhe do të shoqërohen me masa disiplinore.
9. Gjatë kohës së mësim, duke përfshirë edhe pushimet, asnjë nxënës nuk mund të dalë nga shkolla pa leje të drejtorisë, ose kujdestarit të klasës
10. Nxënësi mund të dalë nga shkolla vetëm pas kërkimit të prindit tek drejtoria e shkollës ose kujdestarit të klasës
11. Pajisjet dhe inventari i shkollës duhet të ruhen me kujdes. Shkolla nuk garanton dhe nuk merr përgjegjësi për humbjen e sendeve personale të nxënësve në shkollë (veshje, libra, para, etj.).
12. Të respektojë integritetin e personalitetit të secilit anëtar të personelit të institucionit të arsimit dhe aftësitë e tyre profesionale.
13. Të mbajë uniformën e shkollës gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale.

14. Nxënësi pas mbarimit të mësimit mund të jetë i pranishëm në shkollë vetëm për aktivitete të organizuara nga përgjegjësitë e shkollës ose për orë plotësuese në lëndë të caktuara.
15. Të kujdeset për higjienën dhe rendin në klasë. Përgjegjësi e gjithë nxënësve, veçanërisht e kujdestarëve javorë.

Neni 4

Veprimet e ndaluara

1. Konsiderohen si shkelje të rënda, veprimet si më poshtë:
 - 1.1. Mbajtja e armëve të ftohta dhe të zjarra, si dhe mjeteve të tjera që rrezikojnë jetën e nxënësve dhe personelit të shkollës.
 - 1.2. Veprimet e dhunshme si kërcënimi, konflikti, vandalizmi, mosrespektimi, fyerja ndaj nxënësve dhe personelit në shkollë dhe jashtë saj.
 - 1.3. Bartja dhe konsumimi i drogës, duhanit dhe alkoolit në ambientet shkollore.
 - 1.4. Qasja, bartja dhe keqperdorimi i ditarit të klasës.
 - 1.5. Falsifikimi i nënshkrimit të prindërve, dokumentacionit të shkollës dhe i çfarëdo dokumentacioni që i dedikohet shkollës.
 - 1.6. Plagjiatura.
 - 1.7. Kopjimi i testeve apo provimeve me shkrim të organizuara nga stafi i shkollës.
 - 1.8. Dëmtimi dhe prishja e pajisjeve që i përkasin shkollës, po ashtu pajisjet që shkolla ua ofron nxënësve.
 - 1.9. Sjelljet asociale-devijuese si publikimi i video, foto dhe materialeve të tjera në internet, duke shpërndarë imazhe dhe informacione që nuk i përshtaten anëtarëve të tjerë të shkollës, duke përfshirë nxënësit dhe stafin e shkollës.
 - 1.10. Ngacimimet e ndryshme.
 - 1.11. Nxitja dhe pjesëmarrja në mahi në shkollë dhe jashtë saj.
 - 1.12. Bulizimi ndaj nxënësve të tjerë osë stafit të shkollës.
2. Disa nga shkeljet që janë këtu dhe ato që janë vetëm në kodin e Mirësjelljes, konsiderohen shkelje të rënda edhe sipas kodit të Mirësjelljes, dhe përfundojnë në Komisionin Etik.
3. Për sjellje tjera të paparashikuara mblidhet një komision disiplinor i cili bënë vlerësimin e sjelljes së nxënësit konkret dhe i shqipton masën disiplinore për atë vepër.
4. Konsiderohen si shkelje të lehta, veprimet si më poshtë:

- 4.1.Shkarravitja, demtimi dhe mbishkrimi i mureve, dyerve, dritareve dhe inventarit të shkollës.
- 4.2.Hyrja me vonesë në orën e mësimit ose praktikës profesionale.
- 4.3.Zhurma, shprehjet e pahijshme, cregullimet, lojërat e papërshtatshme dhe demtimet e bazës materiale të shkollës.
- 4.4.Lëshimi i orës së mësimit ose praktikës profesionale pa lejen e mësuesit/punëdhënësit.
- 4.5.Përdorimi i telefonave celularë gjatë orarit mësimor për nxënësit. Nxënësi mund të kontaktojë familjen e tij duke u drejtuar në drejtori në kohë të arsyeshme.
- 4.6.Ndotja e ambientit shkollor dhe hapësirave përreth shkollës.
- 4.7.Sjellje tjera asociale-devijuese të cilat drejtori i shkollës, Këshilli i Klasave dhe Këshilli i Arsimitarëve i cilësojnë si shkelje.

Neni 5

Vijueshmëria në mësim dhe praktikë profesionale

1. Nxënësi i cili mungon pa arsye 15 orë mësimi, i thyhet nota e sjelljes në 3, kjo notë nuk mund të përmisohet më.
2. Nxënësi i cili mungon pa arsye 25 orë mësimi, i thyhet nota e sjelljes në 1, kjo notë nuk mund të përmisohet më.
3. Nxënësi i cili mungon pa arsye më shumë se 32 orë mësimi, i kontaktohet prindi dhe shkëputet kontrata mes prindit dhe institucionit.

Neni 6

Masat disiplinore

1. Për thyerjen e rregullave të disiplinës, veprimet marra për rastet e rënda dhe të përsëritura janë:
 - 1.1.Verëjtje me gojë;
 - 1.2.Verëjtje me shkrim;
 - 1.3.Këshillim nga psikologu i shkollës;
 - 1.4.Pjesëmarrje e ndaluar në aktivitete jashtëshkollore si gara, ekskursione, vizita;
 - 1.5.Nxënësit mund të ndëshkohen me qortim ose këshillim nga ana e drejtorisë së shkollës.
2. Për shkelje të lehta të rregullave, shkolla mund të vendosë pezullim të përkohshëm nga 1 deri në 3 ditë.

3. Pezullim i përkohshëm prej 1 deri në 3 muaj.
4. Paralajmërim i familjeve mund të aplikohet për shkelje të caktuara.
5. Thyerja e notes së sjelljes mund të ndodhë për shkelje të rënda dhe mund të çojë në shkëputjen e kontratës mes prindit dhe shkollës.
6. Evidentimi i shkeljeve bëhet nga ana e Mësimdhënësi, Kujdestari i Klasës dhe Drejtori i Shkollës.
7. Evidentimi dhe shqiptimi i masave disiplinore bëhet sipas procedurës me sa vijon:
 - 7.1.Për shkeljet e rënda masat i shqipton Drejtori dhe Komisioni i Etikës.
 - 7.2.Për shkeljet e lehta, masat i shqipton Drejtori i Shkollës, Mësimdhënësi dhe Komisioni Disiplinor.
 - 7.3.Shkeljet evidentohen në EduPage sipas skemës figurative përmes të ashtuquajturve “kartona”, sikurse është paraqitur në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje dhe është e detyrueshme për zbatim.
8. Në rastet kur shkelja është e rëndë Drejtori i Shkollës ndërmer veprimin e menjëhershëm duke shqiptuar një masë disiplinore, dhe inicion procedurën në Komisionin e Etikës.

Neni 7

Komisioni disiplinor

1. Komisioni Disiplinor, është organ profesional i themeluar nga Drejtori i shkollës, i cili është kompetent për zbatimin e procedurave, në rastet kur bëhet shkelje Rregullores për disiplinë nga ana e nxënësve të BGT-së.
2. Komisioni ka mandat 3 vjecar. Nëse dikujt i përfundon mandati më herët ai/ajo anëtare zëvendësohet për pjesën e mbetur të mandatit.
3. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë: kryetari dhe dy anëtarë tjerë. Kryetari është nga radhët e mësimdhënësve. Dy anëtarët e tjerë janë: një nga radhët mësimdhënësve dhe një nga personli i BGT-së.
4. Në rast të mospërmbylljes së detyrave nga njëri apo të gjithë anëtarët e Komisionit, Drejtori do të bëjë zëvendësimin e tyre pasi ta ketë njoftuar me një raport Këshillin Drejtues të Shkollës.

Neni 8

Komisioni i Ankesave

1. BGT themelon Komisionin e Ankesave si komision i përhershëm me mandat tre vjecar. Nëse dikujt i përfundon mandati më herët ai/ajo anëtarë zëvendësoheyt për pjesën e mbetur të mandatit.
2. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre anëtarë: kryetari dhe dy anëtarë tjerë, një që zgjidhet nga radhët mësimdhënësve dhe një nga personli i BGT-së. Kryetari është nga radhët e mësimdhënësve. Të tre anëtarët emërohen nga ana e Drejtorit të BGT-së.
3. Komisioni i ankesave ka kompetencë të shqyrtoj ankesat ndaj vendimeve të Komisionit disiplinor.
4. Në rast të mospërbushjes së detyrave nga njëri apo të gjithë anëtarët e Komisionit, Drejtori do të bëj zëvendësimin e tyre pasi ta ketë njoftuar me një raport Këshillin Drejtues të Shkollës.
5. Nxënësi ka të drejtë të ankimoj vendimin e Drejtorit të Shkollës, Mësimdhënësit dhe Komisionit disiplinor në afat prej 15 ditësh.
6. Ankesa e nxënësit i drejtohet Komisionit të ankesave dhe dërgohet tek Drejtori dhe Sekretari i Shkollës.
7. Komisioni i Ankesave obligohet që të kthej përgjigje:
 - 7.1. Për shkeljet e rënda, kur ka ardhur deri tek largimi i nxënësit nga procesi mësimor, në afat prej 3 ditësh;
 - 7.2. Për shkeljet e lehta në afat prej 7 ditësh.

Neni 9

Procedura për zbatimin e masave

1. Iniciativën për të gjitha masat, e merr Drejtori, kujdestari i klasës, mësimdhënësi ose udhëheqësi i aktivitetit jashtëshkollor.
2. Për të gjitha masat e marra duhet të njoftohet prindi dhe nxënësi dhe të merren informatat kthyesë se prindi është në dijeni.
3. Nuk mund të shqiptohet asnjë masë disiplinore e caktuar me këtë Rregullore ose akte tjera të BGT-së pa dëgjuar nxënësin. Takimi mes nxënësit dhe Drejtorit shoqërohet me procesverbal. Komisionet janë të obliguar të mbajnë procesverbal për cdo gjë. Procesverbalet dërgohen tek Sekretari i Shkollës.
4. Të gjitha masat duhet të shënohen në ditar dhe në procesverbal.

Neni 10

Hyrja në fuqi


Kjo rregullore hyn në fuqi pas votimit nga këshilli drejtues dhe pas nënshkrimit të saj.


Shtojca 1:


Masat e paraqitura në mënyrë grafike sipas EduPage:


TABELA E MASAVE DISIPLINORE


1																																			
2																																			
3																																			
4																																			
5																																			
6																																			
7																																			
8																																			
9																																			
7																																			
8																																			
9																																			
10																																			


 Paralajmrim për qortim nga profesori për nxenesin


 Përdorimi i fjaleve ofenduese të nxenesit

 Qortim për sjelljen e nxenesit jashtë orës mesimore


 Nxënësit i thirret prindi


 Mos leximi i materialit mesimor

 Mos pajisja e nxenesit me tekste shkollore dhe me mjete tjera të domosdoshme për mesim

 Nxënësi hyn me vonesë në orën mesimore





























 Nxënësi ka ngrënë ushqim në orën mesimore


 Qortim nga profesori për nxenesin

 **1X** Nxënësi qëndron një orë më shumë në shkollë për një ditë


 **3-5X** Nxënësi qëndron një orë më shumë në shkollë për tre deri në pesë ditë

Shembuj të masave disiplinore për nxënësit që marrin kartona


1							
2							
3	  1x	  1x	  1x	  1x	  1x	  1x	  1x

 Paralajmrim për qortim nga profesori për nxenesin


Nxënësi NT, pas tërheqjes së vërejtjes tre ose më shumë herë, ka vazhduar me të njëjtën sjellje, duke penguar orën mesimore. Kjo nuk është hera e parë që ky nxënësi bën të njëjtin veprim.

 Përdorimi i fjaleve ofenduese të nxenesit


Nxënësi NT, gjatë orëve mesimore, ofendon nxënësit e tjerë në klasë. Kjo nuk është hera e parë që ky nxënësi ofendon shokët.

 Qortim për sjelljen e nxenesit jashtë orës mesimore


Nxënësi NT, gjatë pushimit të gjatë, ka vandalizuar derën e klasës, duke e dëmtuar atë.

 Mos leximi i materialit mesimor


Nxënësit NT i janë bërë pyetje rreth materialit të dërguar një javë më parë, por ai nuk ka mundur të përgjigjet në asnjërën nga pyetjet. Kjo tregon se nxënësi nuk e ka lexuar materialin. Kjo nuk është hera e parë që ky nxënës nuk e lexon materialin e dërguar.

 Mos pajisja e nxenesit me tekste shkollore dhe me mjete tjera të domosdoshme per mesim

Nxënësi NT, gjatë orës së mësimit sot, nuk kishte stilolaps ose fletore për të mbajtur shënime. Kjo nuk është hera e parë që ky nxënës vjen pa mjete të nevojshme të punës.

 Nxenesi hyn me vones ne oren mesimore

Nxënësi NT sot ka hyrë me vonesë në orën mësimore pasi është vonuar në kantinë duke marrë kafe. Kjo nuk është hera e parë që ky nxënës vjen me vonesë në orën mësimore.


 Nxënësi ka ngrënë ushqim në orën mësimore

Nxënësi NT sot ka ngrënë ushqim gjatë zhvillimit të orës mësimore. Kjo nuk është hera e parë që ky nxënës konsumon ushqim në klasë.

Secili nga këta karton cilësohet si vërejtje me gojë.

Për çdo vërejtje, hartohet një raport i detajuar për rastin, duke përshkruar se çfarë ka ndodhur. Profesori cakton që nxënësi të qëndrojë një orë në shkollë pas mësimit. Ky qëndrim duhet të realizohet pas një jave. Profesori i lëndës është i obliguar të njoftojë prindin përmes telefonit dhe platformës EduPage, duke përdorur simbolin e orës për masën disiplinore të dhënë. Profesori gjithashtu duhet të caktojë literaturën që nxënësi duhet të përfundojë gjatë qëndrimit të tij në shkollë, nga ora 15:00 deri në 16:00.

KARTONËT FIZIK QË PROFESORËT I POSEDOJNË



Secili profesor do ti ketë me vete në orën mësimore tre kartonë të verdhë dhe tre karton të gjelbër.

Kartoni i gjelbër:

Nëse profesori e lejon nxënësin që të shkojë në tualet apo të dalë nga ora mësimore për ndonjë arsye tjetër me leje të profesorit, nxënësit i jepet me vete kartoni i gjelbër. Nëse kujdestari i ditës e sheh nxënësin në korridor, do t'i kërkojë kartonin për të vërtetuar se ka leje për të dalë nga ora mësimore.

Kartoni i verdhë:

Nëse profesori ka përdorur të gjitha opsionet gjatë orës mësimore dhe nxënësi vazhdon të pengojë orën mësimore, atëherë nxënësit i jepet kartoni i verdhë dhe i kërkohej që të shkojë në administratë. Më pas, dikush nga administrata do të vijë tek klasa dhe rasti do t'i shpjegohet nga profesori i lëndës. Administrata do të merret me nxënësin në fjalë, duke siguruar që ai të mos përjashtohet thjesht nga ora mësimore dhe të lihet i lirë nëpër korridore pa marrë asnjë masë disiplinore.

Shembuj të masave disiplinore për nxënësit që marrin kartonin e tretë në një lëndë

4																											
5																											
6																											
7																											
8																											
9																											
7	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X	3-5X

Nxënësi NT, pas marrjes së tri ose më shumë vërejtjeve, ka vazhduar të sjellë pengesa në orën mësimore. Gjatë verifikimit në EduPage, është vënë re se nxënësi kishte marrë më herët dy kartona të tjerë. Në këtë orë mësimore, nxënësi merr përsëri një karton; ky karton duhet të jetë i kuq dhe nënkupton se nxënësi duhet të qëndrojë në shkollë pas mësimit për tre deri në pesë ditë.

Nëse një nxënës nuk përmirësohet pas një vërejtjeje paraprake dhe merr karton të kuq, ai do të marrë gjithashtu një vërejtje me shkrim nga administrata e shkollës.

Qëndrimi në shkollë pas mësimit duhet të realizohet një javë pas dhënies së masës. Profesori i lëndës është i obliguar të njoftojë prindin përmes telefonit dhe përmes platformës EduPage, duke përdorur simbolin e orës për masën disiplinore të dhënë. Gjithashtu, profesori duhet të caktojë literaturën që nxënësi duhet të përfundojë gjatë qëndrimit të tij në shkollë, nga ora 15:00 deri në 16:00.

Shembuj të masave disiplinore për nxënësit që marrin kartonin e tretë në një lëndë

8	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X	3X
9	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓
10	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖	⊖

Nxënësi NT pasi që ka tre karton të kuqë në tre lëndë të ndryshme, si dhe pas vërejtjeve me gojë dhe me shkrim që ka pasur nuk ka reflektuar, atëherë nxënësi dërgohet në suspendim. Nxënësi kthehet nga suspendimi deri në një vendim tjetër që do të marri shkolla.

TABELA E KARTONËVE TË GJELBËR DHE MEDAJLJEVE

1	✉	🏅	🏆
2	↓	↓	↓
3	🏅	🏅	🏆

✉ Lavdata nga profesori për nxënësin

Nxënësi NT sot ishte shumë aktiv gjatë orës mësimore, duke treguar një interes të veçantë për temën dhe duke kontribuar me ide të vlefshme.

🏅 Nxënësi vlerohet me notën maksimale

Nxënësi NT ka qenë shumë aktiv në mësim për disa orë mësimore radhazi, duke realizuar të gjitha ushtrimet me shumë sukses dhe duke marrë notën maksimale në testin e fundit.



Nxenes shembullor ne mesim / sjellje

Nxënësi NT është gjithmonë një shembull i shkëlqyer për shokët e tij, si në mësim ashtu edhe në sjellje. Sot, ai prezantoi projektin e tij me shumë sukses, duke treguar përkushtim dhe aftësi të larta.



Praise from the class teacher

Nxënësi NT ka treguar një përkushtim të jashtëzakonshëm dhe sjellje shembullore gjatë gjithë vitit shkollor. Ai ka qenë një model për shokët e tij, duke u dalluar jo vetëm për rezultatet e shkëlqyera akademike, por edhe për sjelljen dhe etikën e tij në klasë. Pas shumë kartonëve të gjelbër dhe arritjes së disa medaljeve për performancën e tij të shkëlqyer, i jepet mirënjohje nga kujdestari i klasës. Nxënësi NT është rekomanduar për pjesëmarrje në aktivitete të tjera jashtë shkollës, duke përfaqësuar klasën dhe shkollën tonë me krenari.



Praise from the headmaster

Nxënësi NT, pas shumë kartonëve të gjelbër, medaljeve, notave të larta i jepet mirënjohje nga drejtori i shkollës dhe rekomandohet për pjesëmarrje në aktivitete tjera jashtë shkollës, po ashtu Nxënësi NT ka marrë pjesë aktive në klubin e shkollës dhe ka kontribuar në organizimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore, duke treguar një shpirt të lartë të bashkëpunimit dhe lidërshiptit.

